



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Kumtesë për shtyp  
PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM  
23 tetor 2015

Fondi Monetar Ndërkombëtar  
Uashington, D.C. 20431 SHBA

**Misioni i FMN-së përfundoi vizitën në Kosovë duke arritur marrëveshje në nivel të stafit për rishikimin e parë të Marrëveshjes Stand-By**

Kumtesat për shtyp pas përfundimit të misioneve përfshijnë deklarata të ekipeve të stafit të FMN-së që paraqesin gjetjet preliminare pas një vizite në një shtet. Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN-së dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN-së. Ky mision do të rezultojë në diskutime në nivel të Bordit.

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në udhëheqje të Jacques Miniane, vizitoi Prishtinën gjatë periudhës 12-23 tetor për të kryer rishikimin e parë të programit ekonomik të Kosovës të mbështetur me Marrëveshjen *Stand By* (MSB). Në përmbyllje të misionit, z. Miniane dha deklaratën vijuese:

“Misioni ka arritur marrëveshje në nivel të stafit me autoritetet, që do t’i nënshtrohet aprovimit nga menaxhmenti dhe Bordi Ekzekutiv i FMN-së, lidhur me një varg politikash të cilat janë të nevojshme për ta përmbyllur rishikimin e parë në kuadër të MSB-së. Shqyrtimi nga ana e Bordit Ekzekutiv është planifikuar të mbahet më 16 dhjetor. Përfundimi i rishikimit do t’i mundësojë 28.1 SDR (35 milionë euro) në dispozicion të Kosovës.

“Kosova është duke shënuar përparim të mirë në kuadër të programit të saj ekonomik. Pas një ngadalësimi ekonomik të vitit të kaluar, rritja pritet të rimëkëmbet aferisht 4 për qind në vitin 2015, e shtyrë kryesisht nga kërkesa vendore e nxitur nga të hyra të forta të remitancave dhe rritja në huadhënie bankare. Rritja pritet të përshpejtohet në 3.8 për qind më 2016, mbështetur nga realizimi i investimeve në qendrën skitare të Brezovicës. Në periudhën afatmesme, nevojitet një rritje më e lartë dhe më përfshirëse për t’i ngritur të ardhurat, për të zhvilluar një sektor privat më produktiv dhe për të krijuar vende pune. Ne pershendesim hapat e ndermarra nga autoritetet në drejtim të permbushjes së ketyre objektivave.

“Në këtë kuptim, kemi vërejtur, me një shkallë shqetësimi, se javët e fundit aktivitetet parlamentare kanë ngecur. Një gjë e tillë po vonon miratimin e ligjeve të rëndësishme, disa prej të cilave janë kryesiale për reformat ekonomike qeveritare dhe zbatueshmërisë së programit të Kosovës të mbështetur nga Fondi. Më së rëndësishmi, situata në parlament rrezikon cenimin e besimit të investitorëve, përfundimisht në dëm të të gjithë qytetarëve.

“Performanca në kuadër të programit deri më tani ka qenë e mirë. Autoritetet i kanë përmbushur me lehtësi caqet për muajin gusht në kuadër të programit të mbështetur nga

FMN, si për balancën fiskale ashtu dhe për mbulesat e parasë së gatshme të qeverisë. Gjithashtu, ato kanë bërë përpjekje të lavdërueshme për të frenuar shpenzimet aktuale joproduktive, që është veprim i rëndësishëm për lirimin e hapësirës së duhur për shpenzime kapitale dhe përmirësimin e perspektivave për rritje afatgjate. Të hyrat tatimore janë realizuar mirë, por autoritetet duhet të sigurojnë që disa të hyra të njëhershme – nga agjencia e privatizimit dhe nga shitja e licencave të telekomunikacionit – të materializohen ashtu siç parashihet në buxhet.

“Autoritetet janë duke lëvizur me shpejtësi drejt avancimit të ligjeve të rëndësishme që do të fuqizojnë politikën fiskale dhe do të ndihmojnë nxitjen e rritjes. Së pari, një ndryshim në dispozitën për investime në rregullën fiskale do të ndihmojë në sjelljen e projekteve kapitale shtesë të financuara nga agjencitë shumëpalëshe dhe dypalëshe. Elementet e rëndësishme të inkorporuara në këtë ndryshim kanë për qëllim rritjen e transparencës në procese dhe mbajtjen e borxhit publik në nivel të ulët dhe të qëndrueshëm. Së dyti, miratimi i rregullës për pagat e sektorit publik do të ndihmojë që ndarjet e ardhshme buxhetore për paga publike të rriten në përputhje me trendet e përgjithshme në ekonomi dhe do ta bëjnë Kosovën më konkurruese.

“Duke iu afruar vitit 2016, autoritetet janë të zotuar që të miratojnë një buxhet i cili do të realizojë një deficit prej 98 milionë euro (1.7 për qind të BPV-së), duke përjashtuar projektet e reja të financuara nga donatorët. Për këtë qëllim, është e domosdoshme që autoritetet t’i vazhdojnë përpjekjet e tyre për të frenuar shpenzimet aktuale, përfshirë ato për paga dhe mëditje. Si pjesë e këtij buxheti, ne mbështesim rritjet e shpallura së fundi të përfitimeve të ndihmës sociale, meqë kjo skemë është me fokus të duhur mbi personat më të cenueshëm të shoqërisë. Përveç kësaj, e mirëpresim zotimin e qeverisë që të sigurojë se obligimet që lindin si pasojë e zbatimit të plotë të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti nuk tejkalojnë 23 milionë euro në vit.

Bankat kosovare qendrojnë mire, janë mire të kapitalizuara, likuide dhe profitabile. Kreditimi është rritur dhe kualiteti i asetve ka vazhduar që të përmiresohet këtë vit, ku rritja e kredive është 7.8 për qind deri në fund të Gushtit dhe kredit e keqija mbetin në nivelin prej 7.5 për qind. “Autoritetet gjithashtu kanë shënuar progres të mirë në mbështetjen e stabilitetit financiar dhe identifikimin e masave për të nxitur ndërmjetësimin bankar dhe qasjen në kredi që i duhet Kosovës për të mbështetur një ekonomi më të fuqishme. BQK ka aprovuar një kornizë kualitative të masave të cilat do të mundësojnë rritjen e likutiditetit të bankave në situata emergjente edhe pse tani për tani nuk ka nevojë. Korniza e mbikqyrjes së bankave është duke u përmiresuar në vazhdimësi; Mbikqyrja e bazuar në risk të bankave do të mundësojë të identifikojë dhe të adresojë risqet eventuale. Autoritetet tash së fundi kanë filluar aplikimin e përmbarësive privat të cilat veq janë duke ndihmuar në zbatimin e kontratave dhe heqjen e pengesave strukturore në kreditimin nga bankat. Megjithatë nevojitet ende punë në fuqizimin dhe përmirësimin e zbatimit të kontratave, në këtë kontekst në përhendësim zotimin e autoriteteve në adresimin e pengesave të mbetura në këtë fushë.

“Reformat në proceset e prokurimit publik, të cilat do të përmirësojnë efikasitetin e sektorit publik dhe gjithashtu transparencën dhe qeverisjen, janë në rrugë të mirë. Autoritetet kanë lansuar me sukses prokurimin e centralizuar publik dhe duhet të vazhdojnë tutje me aplikimin e procesit të e-prokurimit për të gjithë tenderët në prokurim të centralizuar. Po ashtu, autoritetet duhet të bëjnë hapa të shpejtë për mbushjen e pozitave të lira në Organin e Shqyrtimit të Prokurimit me individë të kualifikuar, meqë ky është një hap tjetër kritik për të siguruar integritet të sistemit të prokurimit.

“Misioni është takuar me Kryeministrin, Isa Mustafa, Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Bedri Hamza, Ministrin e Financave, Avdullah Hoti, si dhe zyrtarë të tjerë publikë, përfaqësues të sektorit privat dhe partnerë ndërkombëtarë. Staf i Fondit është mirënjohës ndaj autoriteteve dhe të gjithë homologëve të tjerë për bashkëpunim dhe diskutime të shkëlqyeshme.”